



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201501824/8

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Tiranë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit R.Z..*

**Drejtuar :** **Kryeregjistruesit të Zyrës Qendrore të Rregjistrimit  
Pasurive të Paluajtshme**  
Z.Ilirian Muho

**Për dijeni :** **Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së  
Drejtësisë,**  
zj.Llambriola Misto

**TIRANË**

**Z. R.Z**  
Adresa :

**TIRANË**

Z.Kryeregjistrues!

Në procesin e shqyrtimit të ankesës së shtetasit R.Z., në të cilën është pretenduar shkelja e së drejtës të pronësisë, Institucioni i Avokatit të Popullit, konsideron, se, qëndrimi që është mbatur dhe mbahet prej ZVRPP, Korçë, është i parregullt, dhe në çënim të parimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së interes publik dhe të drejtave të personave private, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjshmërisë, sikurse parashikuar në nenin 9, 10, 12 dhe 14 të Kodit të Procedurës Administrative dhe të detyrueshëm në kuptim dhe zbatim të nenit 1 të këtij Kodi.

Çështja për të cilën ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit, qëndron si më poshtë prezantuar.

Në cilësinë e bashkëpronarit mbi pasurinë e fituar në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 2442, datë 30.01.1996, të dhënë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, (AMTP) Fshati Gjurgjavec, Korçë, ankuesi rezulton të ketë kërkuar (aplikimi

nr. 3198, datë 23.07.2014) pajisjen me dokumentet e pronësisë mbi pasuritë e fituar në pronësi sipas AMTP-së të lartpërmendur.

Në përgjigje të kërkesës ((aplikimi nr. 3198, datë 23.07.2014), ZVRPP, Korçë, me shkresën nr. 749 prot, datë 07.08.2014, drejtuar ankuesit R.Z., shprehet se:

*“Pronari të aplikojë për korrigjim kartele. Në vërtetimin që do të sjell nga Komuna duhet të shënojë AMTP nr.2442, datë 30.01.1996”.*

Në këtë qëndrim të shprehur, ZVRPP, Korçë, nuk përcakton shkakun ligjor i cili justifikon mbajtjen e këtij qëndrimi.

Për të mundësuar korrigjimin e kartelës, sikurse bërë të ditur, ankuesi ka kryer aplikimin nr.5027, datë 09.09.2014.

Në përgjigje të këtij aplikimi, ZVRPP, Korçë, me shkresën nr.1015 prot, datë 23.09.2014, shprehet se ;

*“ Ka mospërputhje midis planit të rilevimit dhe LN, që i përket pasurisë nr.86, vol 10, faqe 126.*

*Të korrigjohet plani i rilevimit duke e pasqyruar dhe në deklaratën noteriale.*

*Në bazë të të dhënave të planit të rilevimit që do të paraqisni do të konkludohet dhe për vazhdimin e procedurës së mëtejshme”.*

Pra, sikurse në qëndrimin e shprehur në shkresën nr. 749 prot, datë 07.08.2014, edhe në shkresën nr.1015 prot, datë 23.09.2014, nuk përcaktohet shkakun ligjor i cili justifikon mbajtjen e këtij qëndrimi. Në mënyrë të parregullt, ZVRPP, Korçë, nuk kryen korrigjimin e kartelës së pasurisë sikurse kërkuar prej saj, duke vijuar me kërkesën ndaj ankuesit R.Z. për korrigjimin nga ana e tij të plan rilevimit për pasuritë e përcaktuara në AMTP nr.2442, datë 30.01.1996. Më tej i kërkohej z.Z. që me rastin e korrigjimit të plan rilevimit të për pasurit të kryej dhe nënshkrimin e deklaratës noteriale për kufijtë e pasurisë së tij sipas hartës treguese që disponon ZVRPP, Korçë.

Referuar parashikimit të kryer në nenin 30 të Ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, se:

*“Regjistruesi, në çdo kohë me ose pa kërkesën e personave të interesuar, mund;*

- a) të kërkojë që të bëhet një studim/rilevim për çdo pasuri të paluajtshme, për qëllime të këtij ligji, dhe, pasi të ketë njoftuar personat e interesuar, mund të korrigjojë hartën kadastrale si rezultat i studimit/rilevimit të lartpërmendur;*
- b) të korrigjojë çdo gabim teknik apo material në hartën kadastrale, nëse nuk cënohen intereset e ndonjë personi, duke vënë në dijeni personat e interesuar apo personat që kanë të drejta reale mbi sendin;*
- c) ...*
- d) të korrigjojë me qëllim përmirësimin e hartës kadastrale”.*

Gjithashtu, për *“Korrigjimin nga regjistruesi”*, dhe *“Përmirësimi i kartelave dhe hartave kadastrale”*, neni 63 dhe 64 i Ligjit nr.33/2012 *“Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”*, parashikojnë, se;

*“1.Regjistruesi korrigjon gabimet material në çertifikatën dhe/ose kartelën e pasurisë së paluajtshme, me kërkesë të pronarit, në rastet e mëposhtme:*

*a) në rastin e gabimeve ose mungesave që nuk prekin interesat e një pronari tjetër;*

*b) kur, pas një rievrimi, del se një sipërfaqe e treguar në kartelë nuk është në përputhje me aktin e fitimit të pronësisë. Në këtë rast, regjistruesi njofton më parë të gjithë personat e shënuar në regjistër, të cilët janë të interesuar ose që preken nga ky korrigjim i propozuar;*

...

*3. Urdhri i regjistruesit për korrigjimin e kartelës, në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, mund të rishikohet nga Kryeregjistruesi.*

*Neni 64*

*Përmirësimi i kartelave dhe hartave kadastrale*

*1. Kartelat dhe hartat kadastrale përmirësohen dhe/ose përditësohen pas përfundimit të regjistrimit fillestar të pasurive, kur:*

*a) të dhënat e pasqyruara në to nuk përputhen me ato të aktit të fitimit të pronësisë apo të së drejtës reale, të përdorur për kryerjen e regjistrimit; dhe/ose*

*b) nuk ekziston lidhja mes një karteje dhe një harte kadastrale; dhe/ose*

*c) pozicioni gjeografik i pasurive, i pasqyruar në hartën kadastrale, nuk përkon me pozicionin gjeografik faktik të këtyre pasurive, sipas aktit të fitimit të pronësisë.*

*2. Procesi i përmirësimit/përditësimit të kartelave dhe hartave kadastrale bëhet me urdhër të Kryeregjistruesit, pas propozimit të regjistruesit. Urdhri i Kryeregjistruesit publikohet/njoftohet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.*

*3. Të dhënat e përfituara pas procesit të përmirësimit duhet të afishohen për një periudhë 45-ditore në mjediset e zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe organin e qeverisjes vendore, ku ndodhet e pozicionuar z. ona, e cila i nënshtrohet përmirësimit të të dhënave.*

*4. Brenda afatit të afishimit publik, personat e interesuar kanë të drejtë të paraqesin pretendimet për përmirësimin/përditësimin e të dhënave. Pas periudhës së afishimit publik, sipas pikës 3 të këtij neni, të gjitha pasuritë e paluajtshme, për të cilat nuk ka asnjë pretendim, do të regjistrohen siç janë në kartelat dhe hartat kadastrale të përmirësuara/përditësuara.*

*5. Kushtet dhe procedurat për kryerjen e përmirësimit dhe përditësimit të të dhënave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*Përkundër parashikimeve të sipërcituara, ZVRPP, Korçë, nuk rezulton të ketë marrë masa për zbatimin e parashikimeve të dispozitave të mësipërme ligjore.*

Qëndrimi i ZVRPP, Korçë, për detyrimin e ankuesit që të ndryshojë plan rilevimin e pasurisë si dhe të nënshkruaj deklaratë noteriale për kufijtë e pronës me subjektet kufitare, nuk e gjejmë me vend, kjo për faktin se ankuesi nuk është detyruar ta jap një pëlqim të tillë.

Gabimi i kryer prej ZVRPP, Korçë, në përgatitjen e hartës kadastrale për pasurinë e ankuesit, nuk mund të zgjidhet duke i kërkuar ankuesit të kryej ndryshimet apo të jap me deklaratë noteriale pëlqimin për kufijtë e pronës sikurse pasqyruar nga ana e ZVRPP, Korçë. Duhet kuptuar se, përfituesit e tokës bujqësore në pronësi sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, nuk mund të vendosin apo ndryshojnë kufijtë për pasuritë e përfituara në pronësi. Strukturat shtetërore kanë mundësuar ndarjen e tokës duke bashkëlidhur AMTP-së dhe plan rilevimet për çdo ngastër të përfituar nga familja bujqësore, dhe se këto akte në rrugë zyrtare i janë përcjell zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Është zyra vendore e pasurive të paluajtshme që në bashkëpunim me njësinë e pushtetit vendor ku ndodhet prona, kryen veprimet sikurse parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituar, për korrigjimin e akteve.

Për arsyet e bërë me dije në këtë shkresë, Institucioni i Avokatit të Popullit bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenit 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

## REKOMANDOJMË

*Ushtrimin e kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Korçë, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetasit R. Z.*

Në përfundim të shqyrtimit të rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

*Bashkëlidhur ju dërgojmë:*

*Kërkesë(aplikim) nr.3198, datë 23.07.2014, kryer pranë ZVRPP, Korçë.*

*Kopje të Shkresës nr.749 prot, datë 07.08.2014, të ZVRPP, Korçë, drejtuar ankuesit R.Z.*

*Kërkesë(aplikim) nr.5027, datë 09.09.2014, kryer pranë ZVRPP, Korçë.*

*Kopje të Shkresës nr.1015 prot, datë 23.09.2014, të ZVRPP, Korçë, drejtuar ankuesit R.Z.*

*Kopje të shkresës nr.3710/1 prot, datë 26.05.2015, të ZVRPP, Korçë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.*

*Kopje të shkresës nr.5374/1 prot, datë 04.09.2015, të ZVRPP, Korçë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.*

*Kopje të shkresës nr.6943/1 prot, datë 01.12.2015, të ZVRPP, Korçë, drejtuar Avokatit të Popullit.*

*Kopje të shkresës nr.8661/1 prot, datë 03.12.2015, të ZQRPP, Tiranë, drejtuar ZVRPP, Korçë.*

*Kopje të shkresës nr.8897/1 prot, datë 11.12.2015, të ZVRPP, Korçë, drejtuar ZQRPP, Tiranë.*

*Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONERI**

**Etilda GJONAJ(SALIU)**

**Konceptoi dhe Daktilografoi  
A.Gjoleka**